




Lëndohen tre fëmijë nga zjarri që përfshiu shtëpinë e tyre në Vushtrri

KRONIKA

| December 14, 2020 - 10:20

SHPËRNDAJE:



Tre fëmijë janë lënduar si pasojë e një zjarri, që përfshiu dje në orët e mëngjesit një shtëpi njëkatëshe në Vushtrri.

Rastin e ka raportuar vetë pronari i shtëpisë, ndërsa shkaqet e zjarrit ende nuk janë të ditura.

“Është raportuar se për shkaqe ende të panjohura një zjarr kishte përfshirë shtëpinë njëkatëshe, pronë e viktimës mashkull kosovar. Përveç njësive policore, në vendin e ngjarjes kanë dalë edhe njësitë e tjera relevante si: zjarrfikësit, të cilët e kanë shuar zjarrin, eksperti i zjarreve, Njësiti emergjent për mbrojtje dhe shpëtim Vushtrri, si dhe autoambulanca, pasi tre fëmijë, dy meshkuj dhe një femër, kosovarë, kanë pasur nevojë për trajtim mjekësor, të cilët kishin qenë në shtëpi kur kishte ndodhur rasti”, thuhet në raportin 24-orësh të Policisë.

Njoftohet se dy prej fëmijëve pas trajtimit mjekësor janë liruar, kurse i treti mbetet për trajtim të mëtejshëm në spital në pjesën veriore në Mitrovicë, por sipas informatave nga mjeku bëhet fjalë për lëndime të lehta trupore.

“Në dhomën e shtëpisë është gjetur dhe tërhequr një kasetë metali, në të cilën kishte qenë një armë dhe disa fishekë, të cilat ishin djegur nga zjarri dhe nuk dihet lloji i armës. Lidhur me rastin janë njoftuar autoritetet kompetente, rasti vazhdon të hetohet nga njësitë përkatëse”, theksohet në raport. /Zëri

Më të lexuarat



KRONIKA

| December 13, 2020

Gjermani: 48-vjeçari nga Kosova vret kumatën dhe plagos rëndë vëllaun e tij



KRONIKA

| December 12, 2020

Vidhen lopë në Pejë



KRONIKA

| December 13, 2020

Një shtetas i huaj gjendet i vdekur në Mitrovicë



KRONIKA

| December 12, 2020

Hajnat i hyjnë nga dritarja e banjës në shtëpi, vjedhin një shumë të parave



KRONIKA

| December 12, 2020

Arrestohen tetë persona, kapen duke luajtur bixhoz




KRONIKA

| December 12, 2020


Një e mitur sulmohet me thikë nga motra e saj në Mitrovicë

Të rekomanduara



Shqipëri, kultivimi i kanabisi në rritje për...

December 14, 2020



Vrasja e shqiptares në Gjermani: U mundua ta...

December 14, 2020

Supremja i lë në fuqi dënimet ndaj dy të akuzuarve për përgatitje të sulmeve terroriste në diskoteka, kisha dhe kundër KFOR-it

KRONIKA

| December 14, 2020

Sulmojnë zyrtarët policorë, arrestohen dy persona në Podujevë

KRONIKA

| December 14, 2020

Vdekje e dyshimtë në Kamenicë, gruaja dërgohet pa shenja jete në ambulancë

KRONIKA

| December 14, 2020

Vdes fëmija dymuajsh në një shtëpi në Klinë

KRONIKA

| December 14, 2020

Lëndohen tre fëmijë nga zjarri që përfshiu shtëpinë e tyre në Vushtrri

KRONIKA

| December 14, 2020

Vdes një i burgosur i Dubravës, që po trajtohej në Spitalin Rajonal të Pejës

KRONIKA

| December 14, 2020